


**DEKLARATË E
PËRBASHKËT
PËR THEMELIMIN
E TRUPIT KOMBËTAR
STUDENTOR NË
REPUBLIKËN E
MAQEDONISË
SË VERIUT**



DEKLARATË E PËRBASHKËT PËR THEMELIMIN E TRUPIT KOMBËTAR STUDENTOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Forumi Studentor, Shkup,
8-9 mars 2024.

Preambula

Ne, kuvendet studentore të nënshkruara, që përfaqësojmë organe të ndryshme studentore të [Universitetit të Tetovës, Universitetit Nënë Tereza Shkup, Universitetit Goce Dellçev-Shtip, Universitetit Shën Klimenti i Ohrit, Universitetit Shën Apostull Pali, Universitetit të Evropës Juglindore, Universitetit UAE-FON, Universitet Kolegji Amerikan], duke njohur rëndësinë e unitetit, bashkëpunimit dhe avokimit për përmirësimin e arsimit të lartë, në këtë mënyrë deklarojmë përkushtimin tonë për krijimin dhe pjesëmarrjen aktive në **Trupin Kombëtar studentor (TKS)**.

Neni I: Qëllimi dhe objektivat

1.1 Ne zotohemi për angazhimin tonë për të nxitur një platformë legjitime bashkëpunuese dhe jo-partiake, Trupin Kombëtar Studentor, që synon të avokojë për përmirësimin e standardeve, të drejtave të studentëve dhe përmirësimin e përgjithshëm të arsimit të lartë.

Neni II: Emri dhe komunikimi publik i TKS-së

2.1 Emri zyrtar i kësaj strukture është **National Student Body** në anglisht, **Национално студентско тело** në maqedonisht dhe **Trupi Kombëtar Studentor** në shqip.

2.2 Trupi Kombëtar Studentor do të ketë një logo zyrtare, që simbolizon unitetin, diversitetin dhe aspiratat kolektive të trupit studentor.

2.3 Të gjitha komunikimet, deklaratat dhe publikimet zyrtare të Trupit Kombëtar Studentor do të jenë të disponueshme në gjuhën maqedonase dhe shqipe, duke konfirmuar përkushtimin për qasje, gjithëpërfshirje dhe transparencë.

Neni III: Anëtarësia dhe Përfaqësimi

3.1 Çdo kuvend studentor nënshkruet zotohet të jetë një anëtar aktiv dhe i angazhuar i Trupit Kombëtar Studentor.

3.2 Përfaqësimi në mbledhjet e Trupit Kombëtar Studentor do të udhëhiqet nga Kryesuesi dhe Sekretari i Përgjithshëm i zgjedhur në mënyrë adekuatë. Kryesuesi dhe Sekretari i Përgjithshëm do të shërbejnë si përfaqësues kryesorë, duke siguruar komunikim dhe bashkëpunim efektiv brenda TSK-së.

3.3 Forumi për Ndryshime në Arsim dhe OJQ të tjera do të luajnë rol kyç në kontributin intelektual në punën e Trupit Kombëtar Studentor. Përveç kësaj, ata do të marrin pjesë në mënyrë aktive në mbikëqyrjen e strukturës, duke ofruar njohuri të vlefshme dhe duke promovuar përfshirjen në proceset e vendimmarrjes. Megjithatë, është e qartë se ata nuk do të kenë të drejtë vote në proceset vendimmarrëse, duke mbajtur rolin e tyre mbikëqyrës dhe këshillues.

Neni IV: Vendimmarrja dhe Qeverisja

4.1 Ne pranojmë që Trupi Kombëtar Studentor – TKS të drejtohet nga një strukturë me dy organe, e përbërë nga Bordi Drejtues (d.m.th. Organi politik) dhe Sekretariati (d.m.th. Organi drejtues).

4.2 Ne pranojmë më tej se **Bordi Drejtues** është i ngarkuar me autoritetin **më të lartë vendimmarrës** brenda Trupit Kombëtar Studentor. Vendimet brenda këtij Bordi do të merren në mënyrë demokratike, duke kërkuar një shumicë të thjeshtë, pra, 50% + 1, për të siguruar përfaqësimin kolektiv të kuvendeve tona të ndryshme studentore. Anëtarë të Bordit Drejtues janë Kryetarët e Kuvendeve Studentore të Universiteteve.

4.3 **Bordi Drejtues** i Trupit Kombëtar Studentor mbledhet të paktën dy herë në vit. Megjithatë, në varësi të urgjencës, takimet mund të zhvillohen më shpesh për të trajtuar çështje urgjente dhe për të siguruar vendimmarrje në kohë në përgjigje të nevojave dinamike dhe sfidave me të cilat përballet trupi studentor. Takimet zhvillohen ose online ose në adresën e Kuvendit studentor që kryeson Bordin Drejtues, duke ofruar fleksibilitet dhe qasje për tu përshtatur me vendndodhjet e ndryshme gjeografike të institucioneve anëtare.

4.4 Ne pranojmë më tej se Sekretariati merr rol udhëheqës në drejtimin e punës së Trupit Kombëtar Studentor (TSK). I përbërë nga Sekretari i Përgjithshëm dhe dy zëvendës, Sekretariati luan një rol vendimtar në aspektet praktike, operacionale dhe strategjike të nismave të TSK-së. I zgjedhur nga Bordi Drejtues me një mandat dyvjeçar, përgjegjësitë e Sekretariatit përfshijnë formulimin e politikave, zbatimin e programit dhe koordinimin e përgjithshëm për të siguruar funksionimin efektiv të Trupit Kombëtar Studentor.

4.5 Kuptojmë se Sekretari i Përgjithshëm dhe zëvendësit nuk mund të vijnë nga i njëjti Kuvend Studentor. Kjo dispozitë përforcon angazhimin për diversitet dhe përfaqësim të gjerë brenda Sekretariatit, duke siguruar që perspektivat dhe përvojat e shumta të kontribuojnë në udhëheqjen dhe funksionimin efektiv të Trupit Kombëtar Studentor.

4.6 Ne angazhohemi për të marrë pjesë në proceset demokratike të vendimmarrjes brenda TSK-së, duke iu përmbajtur parimeve të drejtësisë, transparencës dhe gjithëpërfshirjes.

Neni V: Përgjegjësitë

5.1 Çdo Kuvend studentor nënshkruar merr përsipër të kontribuojë në mënyrë aktive në nismat, programet dhe përpjekjet avokuese të Trupit Kombëtar Studentor.

5.2 Trupi Kombëtar Studentor nuk i nënshtrohet interesave të askujt, përfshirë edhe partitë politike. Prandaj, individët që mbajnë poste "ex officio" brenda Trupit Kombëtar të Studentor nuk duhet të jenë të lidhur me asnjë parti politike. Kjo dispozitë siguron pavarësinë dhe jopartizimin e Trupit Kombëtar Studentor, duke e lejuar atë të funksionojë në mënyrë autonome dhe të mbrojë në mënyrë efektive interesat e trupit studentor pa ndikim të jashtëm.

5.3 Ne e njohim rëndësinë e miratimit dhe respektimit të planeve strategjike, operacioneve vjetore dhe rregulloreve të përcaktuara nga Bordi Drejtues dhe Sekretariati. Kjo përfshin respektimin e **Statutit të Trupit Kombëtar Studentor**, që përshkruan funksionimin dhe qeverisjen e strukturës. Angazhimi ynë ndaj këtyre dokumenteve themelore siguron një qasje kohezive dhe efektive për avancimin e qëllimeve dhe objektivave të Trupit Kombëtar Studentor.

5.4 Ne e kuptojmë se Trupi Kombëtar Studentor ka mandat të avokojë për Rezolutën e Forumit Studentor 2024 tek institucionet dhe palët e interesit me kapacitetin më të lartë. Ky zotim i avokimit nënvizon përkushtimin tonë për të avancuar interesat, të drejtat dhe mirëqenien e trupit studentor, siç përshkruhet në Rezolutën e Forumit Studentor 2024.

Neni VI: Rotacioni i udhëheqësisë

6.1 Ne e pranojmë përzemërsisht sistemin e udhëheqjes me rotacion brenda TSK-së, duke përfshirë rotacionin vjetor të Kryesuesit të Trupit Drejtues. Rotacioni i Kryesuesit do të përcaktohet në bazë të madhësisë së universiteteve, duke marrë parasysh numrin e studentëve të regjistruar. Kjo qasje siguron që përgjegjësitë e udhëheqësisë të shpërndahen në mënyrë të barabartë dhe pasqyrojnë diversitetin e popullatës sonë kolektive studentore.

Neni VII: Llogaridhënia dhe transparenca

7.1 Ne zotohemi për mbështetje të llogaridhënies dhe transparencës brenda kuvendeve tona studentore dhe në pjesëmarrjen tonë brenda TSK-së.

7.2 Bordi Drejtues i Trupit Kombëtar Studentor do të emërojë pozitat brenda Sekretariatit në bazë të meritave dhe kompetencave.

Neni VIII: Kohëzgjatja dhe ndryshimi


8.1 Kjo deklaratë e përbashkët hyn në fuqi pas nënshkrimit.

8.2 Ndryshimet në këtë deklaratë mund të bëhen me konsensus të kuvendeve studentore nënshkruese.

Në dëshmi të kësaj, kuvendet studentore të nënshkruara zotohen për angazhimin e tyre për themelimin dhe pjesëmarrjen aktive në Trupin Kombëtar Studentor.


Nënshkrim:

Aleksandar Nikolovski,
Kuvendi i Studentëve në
Universitetin Shën Kirili dhe Metodi




Ladon Murseli,
Kuvendi i Studentëve në
Universitetin e Tetovës


Mevlan Ademi,
Kuvendi i Studentëve në
Universitetin e Evropës Juglindore



Stojanka Kjupceva,
Kuvendi i Studentëve në
Universitetin Shën Klimenti i Ohrit



Sheval Ziza,
Kuvendi i Studentëve në
Universitetin Goce Dellçev Shtip



Stefan Mladenoski,
Kuvendi i Studentëve të UAE-FON



Omer Hebibi,
Kuvendi i Studentëve të
Universitetit Nënë Tereza Shkup



Andrej Asprovski,
Universiteti Kolegji Amerikan



Shkup, 9 mars 2024